



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 7.12.2023

- Lënda:** Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për çështjen ankim kundër vendimit 574, datë 18.10.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Pëllumb Zaimi
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të seancës gjyqësore publike të datës 23.11.2023, që i përket ankimit të Komisionerit Publik, kundër vendimit nr. 574, datë 18.10.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Trupi gjykues, pasi dëgjoi parashtrimet e palëve, kërkimet e subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, vendosi të çelë hetimin gjyqësor të çështjes dhe të administrojë në cilësinë e provës një pjesë të akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit<sup>1</sup>.

Komisioneri Publik, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit<sup>2</sup>, edhe pas shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje, vlerëson se aktet e depozituara nga subjekti dhe të administruara në cilësinë e provës nga Kolegji, nuk ndikojnë në ndryshimin e kërkit përfundimtar.

Në vijim, rezulton se dhe pas shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, në raport me shkaqet e ankimit, mbeti e provuar se:

### ***1. Lidhur me (1) etikën dhe (2) aftësitë profesionale***

**1.1 (1) Lidhur me etikën.** Ashtu sikurse Kolegji ka orientuar në jurisprudencën e tij, si dhe në ushtrim të kompetencave kushtetuese të Komisionerit Publik, është konsideruar me rëndësi që, për vlerësimin e aftësive profesionale, vëmendje t’i kushtohet edhe denoncimit të fakteve nga publiku, kur ekzistojnë kushtet dhe rrethanat e parashikuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>1</sup> Për aktet që janë tashmë pjesë e dosjes dhe për ato që mund të sigurohen përmes burimeve të hapura të informacionit, trupi gjykues u shpreh se nuk ishte i nevojshëm administrimi si provë. Gjithashtu, trupi gjykues i kërkoi subjektit të rivlerësimit që disa akte të paraqitura si fotokopje, t’i risjellë në formën e kërkuar nga ligji, të cilat iu vunë në dispozicion Komisionerit Publik, më datë 4.12.2023. Gjatë kësaj seance, palët duhet të jenë të përgatitura edhe për konkluzionet përfundimtare.

<sup>2</sup> Referuar edhe parashtrimeve me shkrim të administruara gjatë këtij gjykimi.

1.1.1 Për këtë arsye, në ankimin e Komisionerit Publik, ndër të tjera, është arsyetuar në mënyrë të zgjeruar për çështjet e lidhura me konfliktin e interesit, gjatë ushtrimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit, të pretenduara nga dy denoncues<sup>3</sup>, mbi gjykimin e çështjeve gjyqësore civile, ku një ndër palët në proces, qoftë në cilësinë e personit të tretë, ashtu dhe si e paditur, ka qenë ASHK, Drejtoria Vendore Berat, me titullar të saj, znj. \*\*\*. \*\*\*, e bija e subjektit të rivlerësimit. Nga hetimi administrativ kanë rezultuar të evidentuara, *12 çështje civile*, ku palë ndërgjyqëse apo person i tretë ka qenë ASHK, Drejtoria Vendore Berat<sup>4</sup>.

1.1.2 Konflikti i interesit, sipas nenit 3, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë *ose duket* sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisive të tij publike. Një ndër rrethanat që mund të dëshmojnë konfliktin e mundshëm të interesit, janë marrëdhëniet familjare<sup>5</sup>.

1.1.3 Po ashtu, nga hetimi administrativ, ka rezultuar i evidentuar shqyrtimi dhe finalizimi i *rreth 15 çështjeve gjyqësore*, me palë paditëse shoqëri tregtare me kapital publik., ndërkohë që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë zotëruar aksione pranë kësaj shoqërie<sup>6</sup>, të përfituara kundrejt vlerave financiare përkatëse të paguara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur. Edhe në këtë rast, pavarësisht pretendimeve të subjektit, se aksionet e zotëruara konsiderohen të jenë një interes *de minimis*, rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit gjendej në kushtet e konfliktit të interesit sipas nenit 72, pika 1 dhe nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile.

1.1.4 Komisioneri Publik, ashtu sikurse Kolegji, ka interpretuar në jurisprudencën e tij<sup>7</sup>: [...] *mban në konsideratë dhe shtjellimin e konceptit të paanësisë, sipas Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore. Paanësia është esenciale për ushtrimin e detyrës. Ajo gjen zbatim jo vetëm në vendimmarrje, por edhe në procesin që paraprin atë. Gjyqtari duhet të japë dorëheqjen nga pjesëmarrja në një procedim, në të cilin është e pamundur të vendosë në mënyrë të paanshme ose në të cilin një vëzhguesi të arsyeshëm mund t’i duket se gjyqtari e ka të pamundur të vendosë me paanësi [...].*

1.1.5 Për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se, edhe pse këto aksione i janë dhuruar djalit të subjektit të rivlerësimit në pritje të këtij gjykimi, këto rrethana mbi të cilat mbështetet ky shkak ankimi mbetën të pandryshuara gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 23.11.2023 dhe duhen vlerësuar nga Kolegji, në tërësi, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me *paanësinë e magjistratit, në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit*, parashikuar nga neni 75 i ligjit nr. 96/2016 dhe parashikimeve të nenit 72 dhe 73, të K. Pr. Civile.

**1.2 (2) Lidhur me aftësinë profesionale.** Komisioneri Publik, ashtu sikurse ka trajtuar gjerësisht në shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e datës 23.11.2023, ka vendosur në vëmendje të Kolegjit shkeljet e konstatuara në dosjet gjyqësore të administruara nga Komisioni në

<sup>3</sup> Denoncimi i shtetasit \*\*\*. \*\*\*, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*8.2022 dhe denoncim i shtetasit \*\*\*. \*\*\*, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 2\*\*5.2021.

<sup>4</sup> Referuar shkresës me nr.\*\*\*/\*\* prot., datë \*\*9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat.

<sup>5</sup> Neni 5, pika 1 e ligjit nr. 9367/2005, përkatësisht germa “i”.

<sup>6</sup> Nisur nga deklarimi i personit të lidhur, znj. \*\*\*. \*\*\*, në DV-2008, ku deklarohet se znj. \*\*\*. \*\*\*. ka dorëzuar bonot e privatizimit si punonjëse, në shumën 50.000 lekë, ndërsa subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar bonot e privatizimit si jopunonjës për t’u bërë aksionar në shumën 75.000 lekë. Zotërimi i aksioneve nuk është deklaruar në Deklaratën “Vetting”.

<sup>7</sup> Referohuni vendimit (JR) nr. 21/2021, prg. 51.

konsideratë të informacioneve që kanë rezultuar nga agjencitë ligjzbatuese, në drejtim të vlerësimit të integritetit të subjektit të rivlerësimit, si një indikator i rëndësishëm i kriterit të aftësive profesionale.

**1.3** Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se shkaqet e ankimit *mbi vendimin penal nr.\*\*\*, datë \*\*.12.2019*, me shtetas nën hetim *\*\*\*.\*\*\*.*, me viktimë *\*\*\*.\*\*\*.*, dhe *vendimin penal nr.\*\*\*, datë \*\*.12.2013*, me objekt vleftësimin dhe caktimin e masës së sigurisë së shtetasit *\*\*\*.\*\*\*.*, qëndrojnë dhe mbeten të pandryshuara dhe pas parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në seancën e datës 23.11.2023, me arsyetimin si vijon:

1.3.1 Lidhur me *vendimin penal nr.\*\*\*, datë \*\*.12.2019*, pretendimet e subjektit se vepra penale e parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal: “*Vjedhja duke shpërdoruar detyrën*”, është *krim vazhdues*<sup>8</sup> dhe se shtesa e kallëzimit nga Posta Shqiptare sh. a., filiali Berat, pas ankesës së shtetasit *\*\*\*.\*\*\*.*, është *bërë pjesë e procedimit penal nr. \*\*\*/2018*<sup>9</sup>, nuk gjejnë mbështetje në praktikën gjyqësore<sup>10</sup> dhe në aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj. Konkretisht, referuar praktikës gjyqësore dhe mënyrës së formulimit të dispozitave të seksionit I, “*Vjedhja e pasurisë*”, të Kodit Penal, vepra penale e parashikuar nga neni 135, në dallim nga dispozitat e tjera (nenet 134, 136, 137, 137/a, 138/a), nuk parashikon si anë objektive kryerjen *më shumë se një herë* të veprës penale ndaj dhe nuk mund të kualifikohet si krim vazhdues, pasi akti mund të qëndrojë si akt më vete. Referuar akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, vendimi për bashkimin e procedimeve penale mban datën *\*\*.1.2019*, ndërsa shkresa shtesë, kallëzimi e filialit Berat të Postës Shqiptare, mban datën *\*\*.2.2019*, që tregon pamundësinë e përfshirjes në këtë procedim penal, për më tepër në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat, me nr.\*\*\*, datë *\*\*.4.2019*, me objekt dërgimin për gjykim të çështjes penale nr.\*\*\*, të vitit 2018, shtetasi *\*\*\*.\*\*\** nuk është renditur te shtetasit e cituar në vendim se iu është përvetësuar shuma e lekëve të pensionit.

1.3.2 Lidhur me *vendimin penal nr.\*\*\*, datë \*\*.12.2013*, pretendimet e subjektit se: [...] *dëshmia e penaltetit administrohet në fashikullin e gjykimit, kur vendoset dërgimi i çështjes në gjyq dhe nuk ndodh në gjykimin e vleftësimin dhe caktimit të masave të sigurimit personal*<sup>11</sup>[...], nuk qëndron referuar parashikimeve të dispozitave procedurale penale, respektivisht nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale, ku në caktimin e masës mbahen parasysh edhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal, si dhe në shqyrtimin e kushteve për shuarjen apo caktimin e masave të sigurimit kërkohet domosdoshmërisht çmuarja e provave /akteve të përfshira në fashikull, vlerësimin e rrethanave të faktit, nevojave të sigurimit, vlerësim të personalitetit të dyshuarit, vlerësim të rrezikshmërisë së veprës penale dhe autorit, të dyshuarit të saj.

1.3.3 Nga të dhënat e administruara, Komisioneri Publik nënvizon se për këto çështje, referuar dhe informacioneve të organeve ligjzbatuese, konstatohen problematika në treguesin e njohurive ligjore, sipas nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 96/2016, të cilat duhen evidentuar dhe çmuar nga Kolegji në vlerësimin përfundimtar të subjektit, në mënyrë kumulative, në zbatim

<sup>8</sup> Referohuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, protokolluar në Kolegj me nr.\*\*\*/\*\* prot., datë 20.11.2023, f. 11.

<sup>9</sup> Referohuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, protokolluar në Kolegj me nr.\*\*\*/\*\* prot., datë 20.11.2023, f. 10.

<sup>10</sup> Referuar përmbajtjes së vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 284 i vendimit, datë seancë gjyqësore 15.9.2000 dhe 6.10.2000.

<sup>11</sup> Referohuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, protokolluar në Kolegj me nr.\*\*\*/\*\* prot., datë 20.11.2023, f. 12 dhe 13.

të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**1.4** Komisioneri Publik, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit, në kuadër të këtij gjykimi, vlerëson se mbetën të pandryshuara dhe gjejnë mbështetje në aktet në dosje dhe pretendimet e disa prej denoncuesve, konkretisht:

1.4.1 (1) *Denoncim i shtetasit* \*\*\*. \*\*\*.<sup>12</sup> Sikundër ka konstatuar dhe Komisioni, mbetet e provuar se subjekti ka përdorur shprehje joetike për figurën e magjistratit, të tilla që cenojnë parimet e përcaktuara në Kodin e Etikës Gjyqësore (parimin e Integritetit, Sjelljes së hijshme dhe Vetëpërmbytjes, Respektit dhe Aftësisë për të dëgjuar etj.), duke afektuar në këtë mënyrë treguesin e parashikuar nga neni 75, pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 96/2016, dhe duhen vlerësuar nga Kolegji në tërësi, në mënyrë kumulative, në zbatim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

1.4.2 (2) *Denoncim i shtetasit* \*\*\*. \*\*\*.<sup>13</sup> Nga të dhënat e administruara nga denoncimi, konstatohen problematika në treguesin e njohurive ligjore, sipas nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 96/2016, të cilat duhen evidentuar dhe çmuar nga Kolegji në vlerësimin përfundimtar të subjektit, në mënyrë kumulative, në zbatim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016. Pretendimet e subjektit: [...] *se shtetasit e përfshirë në konflikt, janë zënë dhe konfliktuar brenda ditës dy herë me njëri-tjetrin, në vende të ndryshme*<sup>14</sup> [...], nuk provojnë të kundërtën e faktit që vendimi i marrë nga subjekti i rivlerësimit<sup>15</sup>, trajton të njëjtat rrethana, të njëjtit shtetas në konflikt dhe bazohet mbi të njëjtin akt mjeko-ligjor, mbi të cilin Gjykata ishte shprehur tashmë, në një vendim të mëparshëm të datës \*\*.12.2019 (nga një subjekt tjetër rivlerësimi).

1.4.3 (3) *Denoncim i shtetasit* \*\*\*. \*\*\*.<sup>16</sup> Në rastin konkret, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, në treguesin e njohurive ligjore sipas nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 96/2016, pasi vendimi i ndërmjetëm, datë \*\*.2.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, ku një nga anëtarët është subjekti i rivlerësimit, z. Pëllumb Zaimi, lënë në fuqi me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*.4.2022, të Gjykatës së Apelit Vlorë, nga të dhëna të marra nga burime të hapura të informacionit, rezulton të jetë prishur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili ka gjetur të gabuar arsyetimin dhe disponimin e gjykatave të faktit në rastin konkret, duke parashtruar argumentet dhe interpretimin gjyqësor, përkatësisht në paragrafët nr. 11-18 të këtij vendimi.

1.5 Në përfundim të sa më sipër, Komisioneri Publik, lidhur me etikën dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në ushtrim të funksioneve të tij kushtetuese, në drejtim të mbrojtjes së interesit të publikut, kërkon vlerësimin e trupit gjykues, për problematikat e konstatuara në kriterin e aftësive profesionale, të bëra pjesë të hetimit administrativ të Komisionit dhe këtij gjykimi, për shkak të informacioneve të organeve ligjzbatuese dhe denoncimeve publike, problematika që duhen vlerësuar nga Kolegji, në zbatim të nenit 4, pika 2, kundrejt parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

<sup>12</sup> Protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.7.2020.

<sup>13</sup> Protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë \*\*.9.2022.

<sup>14</sup> Referuar Apelit kundërshtues, të datës 7.12.2022, f. 7 të tij, si dhe parashtrimeve të mbajtura nga subjekti në seancën e datës 23.11.2023.

<sup>15</sup> Regjistruar me kërkesën e palës sipas nenit 59 të K. Pr. Penale, me datë \*\*.5.2021, rreth dy vite pas ngjarjes.

<sup>16</sup> Protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.9.2022.

## **2. Lidhur me vlerësimin e pasurisë**

2.1 Për pasurinë: “*Apartament me sipërfaqe 86 m<sup>2</sup>*”, ndodhur në \*\*\*, Tiranë, subjekti i rivlerësimit, dhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me pamjaftueshmëritë e konstatuara për mbulimin me burime të ligjshme të kursimeve, shpenzimeve dhe pagesave të kryera për pasurinë *apartament*, për vitet 2005, 2007 dhe 2008, pamjaftueshmëri që gjejnë trajtim më të gjerë në ankim dhe parashtrimet e seancës gjyqësore paraardhëse.

2.1.1 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, këto pamjaftueshmëri të konstatuara lidhur me *kursimet* e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi të pasurisë “*Apartament, me sipërfaqe 86 m<sup>2</sup>*”, ndodhur në \*\*\*, Tiranë, duhen marrë në konsideratë nga Kolegji në një vlerësim tërësor në zbatim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

2.2 Për pasurinë “*Apartament 1+1, ndodhur në lagjen ‘\*\*\* \*\*’, Berat*”, subjekti i rivlerësimit, dhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me sa konstatuar në ankim dhe në parashtrimet e datës 23.11.2023. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në D-Vett., lidhur me pasurinë *Apartament 1+1, ndodhur në lagjen ‘\*\*\* \*\*’, Berat*, si dhe nuk arriti të qartësojë marrëdhënien e tij me këtë pasuri, referuar bazës ligjore (VKM) dhe detyrimeve që rridhnin prej saj në marrëdhënien e posaçme juridike me UK Berat-Kuçovë, lidhur me cilësinë dhe të drejtat pronësore që subjekti i rivlerësimit kishte mbi këtë apartament. Referuar deklaramëve të vetë subjektit të rivlerësimit rezulton që ky apartament është përdorur prej tij dhe familjes së tij për 10 vjet, si dhe për apartamentin në fjalë, subjekti ka pasur një kontratë furnizimi me ujë të lidhur me Ujësjellës - Kanalizime Berat-Kuçovë<sup>17</sup>.

2.2.1 Në kushtet kur aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit referojnë të dhëna kontradiktore ndërmjet tyre, si dhe nuk qartësojnë të drejtat reale të subjektit lidhur me këtë pasuri, Komisioneri Publik vlerëson se ndodhemi në kushtet e pamundësisë objektive për të kontrolluar këtë pasuri. Këto rrethana të padeklaruara nga subjekti dhe në Deklaratën “*Vetting*” duhen marrë në konsideratë nga Kolegji, në një vlerësim tërësor, në zbatim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

### **Kërkimi i ankimit**

3. Duke përfunduar për sa parashtruam, Komisioneri Publik, bazuar në nenet Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenin 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016; dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 574, datë 18.10.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Pëllumb Zaimi.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**

<sup>17</sup> Referohuni shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në parashtrimet e protokolluara nga Kolegji në datën 20.11.2023 (f.18) dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti në Apelin kundërshtues të datës 7.12.2022.